

## Ditëlindjet

Hermona Kadiza 29 Maj, Bledar Valca 8 Qershor, Erma Gjocaj 12 Qershor, Arjan Muca 14 Qershor, Kamila Hyka 26 Qershor.

*Ju urojmë Gëzuar Ditëlindjen duke falenderuar Perëndinë për dhuratën e bukur të jetës! Jemi të bekuar që jeni pjesë e familjes tonë! Zoti ju bekoftë!*

## Shpirtëlindjet

Alfred Nini 3 Qershor, Arjan Muca 11 Qershor, Klesta Grabovari 13 Qershor, Fatbardha Emiri 15 Qershor, Ilir Gjerazi 17 Qershor.

*Ju urojmë Gëzuar Ditëlindjen Shpirtërore! Dita që vendosët të visheni me Krishtin ishte dita më e rëndësishme e jetës tuaj!*

## Veprimtaritë e muajit Qershor

## Takimet tona

<b>E Diel</b>	<b>Studimi biblik i Fëmijëve</b>	<b>Ora - 10:00</b>
	<b>Studimi Biblik</b>	<b>Ora - 10:00</b>
	<b>Takimi i të Rinjve</b>	<b>Ora - 10:00</b>
	<b>Shërbimi i Adhurimit</b>	<b>Ora - 11:00</b>
	<b>Shërbimi i Mbrëmjes</b>	<b>Ora - 18:00</b>
<b>E Martë</b>	<b>Takimi i Motrave</b>	<b>Ora - 19:00</b>
<b>E Mërkurë</b>	<b>Takimi i mesjavës</b>	<b>Ora - 19:00</b>

<b>Pjesëmarrja për datën</b>	<b>17/6/2018</b>	<b>63</b>
<b>Kontributi për datën</b>	<b>17/6/2018</b>	<b>35,685 leke</b>

## Shërbimi i Adhurimit

	<b>24 Qershor</b>	<b>1 Korrik</b>
<b>Këngët</b>	<b>K. Findiku</b>	<b>A. Hyka</b>
<b>Lutja e parë</b>	<b>K. Findiku</b>	<b>A. Hyka</b>
<b>Studimi biblik</b>	<b>B. Valca</b>	<b>B. Valca</b>
<b>Lutja e dytë</b>	<b>A. Veshti</b>	<b>A. Zhusti</b>
<b>Predikimi</b>	<b>B. Valca</b>	<b>A. Xhaferaj</b>
<b>Darka e Zotit</b>	<b>Sh. Patria</b>	<b>E. Gjocaj</b>
<b>Oferta</b>	<b>A. Muca</b>	<b>K. Findiku</b>
<b>Lutja e tretë</b>	<b>A. Hyka</b>	<b>S. Haxhiu</b>
<b>Predikimi pasdite</b>	<b>B. Valca</b>	<b>E. Qirjaqi</b>
<b>E Mërkurë</b>	<b>B. Valca</b>	<b>B. Valca</b>

### I dashur mik / E dashur mikeshë,

Faleminderit që je bashkuar me ne në adhurimin e Perëndisë. Ky Perëndi dashurie dhe drejtësie, dëshiron të ketë një marrëdhënie me ty. Për këtë, Ai dërgoi Birin e Tij, Jezus Krishtin të vdesë në kryq për mëkatet tona dhe të ringjalljet për drejtësimin tonë. Edhe ti mund të hysh në marrëdhënie me Të nëse e beson planin e Tij për jetën tënde, duke hequr dorë nga jeta e jetuar pa Të për t'ju kthyer Atij me gjithë mendje e zemër, duke e deklaruar besimin tënd tek Jezusi dhe duke u pagëzuar për faljen e mëkateve. Ai premtan se jo vetëm do të falë mëkatet por do të japë dhe Frymën e Tij si dhuratë për të ndihmuar të jetosh për Të cdo ditë. Në fund, nëse i qëndron besnik Atij, Ai do të të japë kurorën e jetës dhe do të vendosë të jetosh në prezencë të Tij, përgjithmonë.

Të krishterët, si ndjekës të Jezusit duhet ta jetojnë besimin e tyre përmes veprimtarive të përditshme duke i ofruar jetët e tyre si një flijim të gjallë për Zotin dhe kur mblidhen së bashku në Ditën e Parë të Javës e shprehin mirënjohjen për Perëndinë duke e përlehtëuar Atë me frytin e buzëve dhe melodinë e zemrës, duke u lutur, duke marrë nga buka dhe fryti i hardhisë në përkujtim të vdekjes së Tij, duke dëgjuar vullnetin e Tij për jetën e tyre përmes mësimit dhe predikimit të Fjalës së Tij dhe duke kontribuar financiarisht nga të ardhurat e tyre.



## KISHA E KRISHTIT, TIRANË

Rruga Maliq Muça, Nr. 37 Tel. +355-4 222-80-99

**24 Qershor 2018**

*Ne jemi një grup njerëzish me prejardhje e moshë të ndryshme që mblidhemi për të adhuruar dhe punuar së bashku për lavdi të Perëndisë, me ndihmën e të cilit përpiqemi të japim dhe të bëjmë më të mirën tonë.*

*E duam Perëndinë për atë që ka bërë për ne nëpërmjet Jezusit. Përpiqemi të imitojmë Krishtin dhe ta ndjekim Atë deri në fund të ditëve tona. Besojmë në autoritetin absolut të Biblës dhe në faktin që ajo është tërësisht e frymëzuar.*

*Ju ftojme të bashkoheni me ne gjatë javës në takimet e gëzueshme të atyre që e duan Perëndinë. Është e mrekullueshme të jesh i Krishterë dhe pjesëtar i familjes së Perëndisë!*

## Lavdi do të kthehet, Mbreti do të vijë!

ZAKARIA ISHTE BASHKEKOHES I PROFETIT HAGAI, Zorobabelit, qeveritarit; dhe Jozueut, birit të kryepfitit. Tempulli nuk ishte rindërtuar ende, dhe njerëzit të cilët u kthyen nga internimi, ndodhen në një mjerim dhe në një rraskapitje emocionale. Endrrat për t'i risjellë dinjitetin Izraelit duket një iluzion. Shumë kanë "**mundur të përçmojnë ditën e gjërave të vogla**" (Zakaria 4:10).

Me përpjekje të padobishme, Zakaria, po i bën thirrje popullit të Perëndisë ta shohë me sy realistë gjendjen në të cilën ndodhen. Pjesa e parë e profecisë (1-8), e cila paraqet një seri thëniesh dhe vegimesh që këshillojnë njerëzit, me sa duket në mëshirën e kombeve pagane, të pendohen dhe të marrin zemër sepse Perëndia është në mes të tyre. Jozueu është shuguruar kryepfit, duke e treguar suksesin në ringritjen e tempullit (6:9-15). Njerëzit duhet të veprojnë me drejtësi, mëshirë dhe me një zemër të bindur përpara Perëndisë (7). Izraeli, megjithëse me reputacion të ulët në sytë e johebrenjve, do të veprojë për përmbushjen e premtimit fillestar që iu bë Abrahamit (Zan. 12:1-3), duke u bekuar për të qenë një bekim për kombet e tjerë (8:21-23).

Pjesa e dytë e librit (9-14), na drejton tek Mbreti që do të vijë dhe do të restaurojë më në fund lavdinë e Perëndisë dhe fatet e njerëzve. Armiqtë e Izraelit do të përbalhin gjykimin (9:1-8) dhe Mbreti do të vijë:

*Ngazëllo me të madhe, o bijë e Sionit,  
Lësho britma gëzimi, o bijë e Jerusalemit!  
Ja, mbreti yt po vjen,  
ai është i drejtë dhe sjell shpëtimin,  
i përvullur dhe i hipur mbi një gomar,  
mbi një gomar të ri (9:9).*

Perëndia do t'i shpëtojë njerëzit e Tij (9:14-10:12), edhe pse, bari i padenjë i Judës, do të gjykohet (11). Zakaria bëhet një bari që do të mohohet nga njerëzit e tij (11:12-13), duke parathënë tradhtinë e Krishtit nga Juda (Mateu 27:9-10). Në fund, Zoti do të goditet (Zak.13:7), por do të shpëtohen njerëzit e tij të penduar: "**Do të derdh mbi shtëpinë e Davidit dhe mbi banorët e Jerusalemit Frymën e hirit dhe të përgjërimit; dhe ata do të vështrojnë drejt meje, drejt atij që kanë therrur; do të pikëllohen për të, ashtu si pikëllohesh për një bir të vetëm, dhe do të hidhërohen shumë për të, ashtu si hidhërohesh fort për një të parëlindur.**" (12:10).

## Kërkesa për Lutje

*-Falenderojmë Perëndinë për përgjigjet e lutjeve tona.*

*-Le të lutemi për të gjithë përpjekjet që do të bëhen këtë vit për të sjellë njerëz tek Krishti dhe për t'i ndërtuar ata në besimin tek Krishti. Mësuesit për fushatën me IBA do vijnë shpejt dhe kampi do të jetë në Korrik-Gusht (21 Korrik deri më 11 Gusht).*

*-Të vazhdojmë të mbajmë në lutje motrën tonë **Geri Mërtiri**, e cila iu nënshtrua një operacioni për gjendrat tiroide disa ditë më parë. Të lutemi që analiza e biopsisë dhe analiza të tjera të kenë përfundime të mira dhe pa probleme në të ardhmen.*

*-Të vazhdojmë të mbajmë në lutje mamanë e motrës sonë **Kestela**. Familja e saj ka shume nevojë për lutjet tona. Të lutemi që Perëndia të lehtësojë dhimbjet e saj.*

*- Të vazhdojmë të mbajmë në lutje motrën tonë Maudine Ady. Ajo është rrëzuar para disa ditësh dhe ka thyer kockën e legenit. Falë lutjeve tuaja dhe vëllezërve e motrave nga gjithë bota, ajo ka filluar të ndihet më mirë dhe Dick Ady dhe mbesat po përpiqen të shikojnë mundësinë për t'u bashkuar me ne gjatë kësaj vere.*

*-Të mbajmë në lutjet tona të gjithë nxënësit e shkollave të mesme dhe nxënësit e shkollave 9 vjecare ndërsa janë në sezonin e tyre të provimeve.*

*-Të lutemi për **Irtën**, kushërirën e motrës sonë Fabiana Bedri, e cila është shtatzënë por që kohët e fundit ka pasur probleme me shëndetin. Perëndia qoftë me të.*

*-Të mbajmë në lutje disa familje të veçanta në kishën tonë, të cilët po përballesh me probleme financiare dhe shëndetësore në familjet e tyre këto kohë.*

## Këndi i Lajmërimeve

- \* **Të gjitha kërkesat për lutje dhe njoftime, mund t'i drejtoni duke telefonuar tek zyrat në numrin 04/222-80-99 ose në adresën: [weitirana@gmail.com](mailto:weitirana@gmail.com), deri të enjten paradite.**
- \* Fushata e verës fillon nesër. Ne i urojmë mirëseardhjen **Pete and Pam Bogdanovic, David and Christina Brazzel, Greg and LaDon Weston**, të cilët janë gjashtë mësuesit e parë të saj. Nëse jeni të interesuar ose keni një të afërm, mik apo koleg që ka interes për të studiuar në këto kurse, kontaktoni Sadeten. Lutemi merrni edhe kopje të lajmërimit për këtë event tek Sadetja.
- \* **MOS HARRONI!** Për shkak të fushatës dhe vapës, studimi i mesjavës ditën e martë dhe të mërkurë është zhvendosur dhe do të vazhdojë kështu deri në fund të shtatorit, në orën 19:00. Adhurimi i të dielës pasdite mbetet në orën 18:00.
- \* Të dielën në mëngjes, në studimin e Biblës do të studiojmë nga profecia e Oseas. Duke qenë se buletini dërgohet përpara të dielës, ju nxisim të lexoni gjithë Osean ose të paktën tre kapitujt e parë. Bledi do të na udhëheqë në këtë studim.
- \* Në studimin e mesjavës jemi duke studiuar nga unguilli sipas Mateut. Në këtë studim, ne do të përqendrohemi vetëm tek parimet kryesore që lidhen me të vërtetën e madhe që Jezus Krishti është Mbreti që themeloi Mbretërinë e Qiejve në të cilën jemi pjesë. Për këtë javë, lexoni kapitullin 10. Studimi po drejtohet nga Bledi.
- \* Të dielën në mëngjes (24 qershor), në studimin e të rinjve, ne përfundojmë studimin nga letra e Jakobit. Duke nisur nga e diela e parë e korrikut, ne do të studiojmë disa nga cilësitë e karakterit të Perëndisë. Të dielën në orën 10:00.
- \* Rregjistrohuni për kampin e krishterë. Për secilën javë ato mbyllën dy javë para fillimit të asaj jave. Datat e fillimit për secilën javë janë 21 korrik, 28 korrik, 4 gusht.

*Kështu thotë Zoti i ushtrive: "Në ato ditë dhjetë burra nga të gjitha gjuhët e kombeve do të zënë një Jude nga cepi i rrobës dhe do të thonë: "Ne duam të vijmë me ju sepse kemi dëgjuar se Perëndia është me ju".*

*~ Zakaria 8:23*